



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Puneve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs

THE
AMBASSADOR
PARTNERSHIP
CORPORATE DIPLOMACY

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

PARTNERITETIT AMBASADOR LLP ¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Partneriteti Ambasador LLP (këtej e tutje të referuar si “Nënshkruesit”),

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës dhe të GATSHËM për të promovuar bashkëpunimin me të ngushtë në trajnimin e diplomatëve:

Kanë rënë dakord, si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Objektivi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është që të krijojë kushtet për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Neni 2

Bashkëpunimi

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave përkitazi me programet e tyre përkatëse të studimit dhe hulumtimit, seminareve si dhe aktiviteteve tjera akademike dhe trajnimeve.

Palët mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit në kuadër të fushave të objektivave të këtij memorandumi.

Neni 3

Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të promovojnë, kontaktet dhe shkëmbimin e stazhierëve, ekspertëve dhe hulumtuesve.

Palët do të inkurajojnë studimin dhe hulumtimin, si dhe shkëmbimin e informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i informatave

Palët do të shkëmbejnë informata dhe pikëpamjet e tyre lidhur me trendet ndërkombëtare dhe avancimet në trajnim dhe studime në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhënie ekonomike me jashtë, shkenca politike si dhe në fusha tjera relevante.

Neni 5

Projektet e ndërmarra bashkërisht

Palët do të vendosin, specifikat dhe logjistikën e secilit projekt që ata ndërmarrin bashkërisht. Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të lidhen protokollat që përcaktojnë termat dhe kushtet e shkëmbimeve të propozuara.

Neni 6

Kushtet financiare

Për format, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të të Nënshkruarve, do të bihen dakord ndërmjet Nënshkruesve.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet përkitazi me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen përmes pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë të ketë efekt për një periudhë prej tre vjetësh. Pas kësaj, ky mund të ripërtërihet automatikisht për periudha të njëjta, përveç nëse ndërpritet nga ndonjëra Palë, duke i paraqitur njoftimin me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditësh Palës tjetër, para datës së përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i Memorandumit nuk do të ndikojë në projektet që janë në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, nënshkruesit në vijim, të autorizuar për efektet, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

BËRË në Londër dhe Prishtinë, më 16 Shkurt 2015, në dy origjinale, në Gjuhën Angleze, duke qenë njëlloj autentike.

Për Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës

Për Partneritetin Ambasador LLP

Skender Durmishi, Drejtor

Richard Schiffer, Bashkë-Kryetar